



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR VJOSË

Nr 14/6 Prot

Vlorë, më 20.07. 2023.

VENDIM

Nr. 4 , datë 13.07.2023

PËR

**MIRATIMIN E AUTORIZIMIT “PËR PËRDORIM BURIMI UJOR” PËR
NDËRTIMIN, RINDËRTIMIN, APO SHEMBJEN PËR MBROJTJEN E BRIGJEVE,
MUREVE, PRITAVE E VEPRAVE TË TJERA NË BRIGJE, ME VENDNDODHJE:
LUMI BORSHIT, BASHKIA HIMARË, QARKU VLORË**

Në mbështetje të shkronjës “b” të pikës 2, të nenit 41, të ligjit nr.111/2012, “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, i ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim për dhënien me koncension të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujrave të pëdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimarrjes, të formateve të lejes, të autorizimit, të kushteve të posaçme dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Vjosë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e autorizimit, “Për përdorim burimi ujor”, për ndërtimin, rindërtimin, apo shembjen për mbrojtjen e brigjeve, mureve, pritave e veprave të tjera në brigje, me vendndodhje: Lumi Borshit, Njësia Administrative Lukovë, Bashkia Himarë, Qarku Vlorë, për subjektin “Bashkia Himarë”.

2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Emri i burimit ujor: Lumi Borshit

Vendndodhja e burimit ujor (KRGJSH).

Koordinatat e konturit për objektin : “Rehabilitimi i Lumit të Borshit”.

